



KOMPANIA RAJONALE UJESJELLESIT SH.A.
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
REGIONALNA KOMPANIJA ZA VODOSNABEVANJE D.D.

PRISHTINA



RAPORTI TM2 TË KRU “PRISHTINA” Sh.A., PËR VITIN 2023

Vendimi: (I-20)

Bordi i Drejtorëve të KRU “Prishtina” Sh.A., i emëruar me Vendimin e Qeverisë nr.08/81, të datës 01.06.2022, në mbledhjen e njëzet të rregullt të mbajtur me datë 24.08.2023 pas shqyrtimit dhe analizimit paraprak të Raportit TM2 të KRU “Prishtina” Sh.A., për vitin 2023, në mënyrë unanime aprovoi Raportin TM2 për vitin 2023.

Raporti TM2 të KRU “Prishtina” Sh.A., për vitin 2023 do të dorëzohet në NJPMNP në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë.

	Delegoj	Aprovoj
Emri dhe mbiemri:	Kryeshefi Ekzekutiv Z. Arsim Fetahu	Kryesuesja e BD-së Znj. Teuta Ukshini-Aliu
Nënshkrimi:		
Datë:	24.08.2023	24.08.2023





KOMPANIA RAJONALE UJËSJELLËSIT SH.A.
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
REGIONALNA KOMPANIJA ZA VODOSNABEVANJE D.O.

PRISHTINA

RAPORT TM2-2023

KRU "PRISHTINA" Sh.A. – PRISHTINË

PËRMBAJTJA

I.	AKTIVITETET E KRYESHEFIT EKZEKUTIV	3
1.1	Aktivitetet kryesore	3
II.	DEPARTAMENTI TEKNIK.....	5
2.1	Prodhimi	5
2.2	Situata e furnizimit	7
2.3	Detektimi	8
2.4	Intervenimet ne rrjet	9
2.5	Shërbimi i ndërrimit të ujëmatësëve.....	11
2.7	Aplikime për kycje të reja	12
2.8	Projektet për zbatim/Investimet Kapitale/Plani i Prokurimit/DPZH.....	12
2.9	Problemet e evidentuara	13
2.10	Masat e propozuara.....	13
2.11	Aktivitetet për zvogëlimin e UPF-së	13
III.	DEPARTAMENTI KOMERCIAL.....	14
3.1	Numri i konsumatorëve	14
3.2	Faturimi -m3	16
3.3	Faturimi -€	17
3.4	Arkëtimi - €.....	19
3.5	Ankesat/Kërkesat teknike dhe komerciale.....	21
3.6	Inspektimi dhe Shkycja	22
3.7	Aktivitetet kryesore	23
3.8	Problemet e evidentuara	23
3.9	Masat e propozuara.....	24
IV.	DEPARTAMENTI I FINANCAVE	24
4.1	Aktivitetet kryesore	24
4.2	Shpenzimet – TM2-2023	25
4.3	Arsyeshmëria e shpenzimeve.....	26
4.4	Problemet e evidentuara	27
4.5	Masat e propozuara.....	27
4.6	Transaksionet kryesore.....	27
V.	DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS.....	28
5.1	Personeli.....	28
5.2	Përmbaruesit privat	28
VI.	AUDITORI I BRENDSHËM.....	29

VII.	ZYRA E PROKURIMIT	30
VIII.	DEPARTAMENTI I CILËSISË DHE BURIMEVE TE UJIT	33
8.1	Qëllimet.....	34
8.2	Aktivitetet apo përshkrimi i shkurtër i punëve të kryera brenda muajit raportues	34
8.3	Punët e planifikuara në shërbime përkatëse dhe shkalla e realizimit të tyre	35
8.4	Shërbimi kualiteti i ujit pijshëm	35
IX.	DEPARTAMENTI I TEKNOLOGJISË INFORMATIVE	37
9.1	Aktivitet kryesore.....	37
X.	PERFORMANCAT E PËRGJITHSHME.....	38
10.1	KRU „PRISHTINA“ SH.A – TM2-2023	39
10.2	KRU „PRISHTINA“ SH.A – TM1-TM2/2023.....	39
10.3	KRU „PRISHTINA“ SH.A – TM2-2022/2023	40
XI.	PASQYRAT FINANCIARE	41
11.1	Bilanci	42
11.2	Pasqyrat e të ardhurave	44
XII	REALIZIMI I CAQEVE -KRU „PRISHTINA“ SH.A	45
XIII	REALIZIMI I CAQEVE -KRU „PRISHTINA“ SH.A	46
XIV.	ORGANOGRAMI.....	47

I. AKTIVITETET E KRYESHEFIT EKZEKUTIV

1.1 Aktivitetet kryesore

Përgjatë muajve të periudhës së TM2-2023 prill-maj-qershor, janë zhvilluar aktivitete në fusha të ndryshme, me fokus zhvillimi i fushë veprimtarisë së ndërmarrjes që ishte vijimësi e periudhës së TM1, i pashmangshëm, gjithnjë për përmirësimin e performancës së KRU "Prishtina" Sh.A. Ndërmarrja ka vazhduar të operojë me sukses edhe gjatë kësaj periudhe raportuese, duke bërë fillimisht përgatitje intensive në luftimin e kyçjeve ilegale në sistemin e rrjetit të ujësjellësit dhe keqpërdoruesit e formave të ndryshme, si fillim për të ndikuar në mënyrë indirekte në rritjen e performancës së KRU-Prishtina.

Takimet zyrtare kanë pasë për qëllim diskutimin për: faturim, inkasim, infrastrukturë të rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, mundësitë për bashkëpunim dy palësh, diskutim për zonat të cilat ende nuk kanë çasje në sistemin publik të ujësjellësit, siguria dhe emergjencat, projektet kapitale në zgjerimin e infrastrukturës. Janë realizuar shumë takime zyrtare të temave prej më të ndryshmeve, të cilat po ua përcjellim si në vijim. Disa nga aktivitetet kryesore:

Prill 2023

- Takim zyrtar me Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës,
- Takim zyrtar me KFOR-in Britanez, Njësi Speciale,
- Takimi me Drejtorin për Siguri dhe Emergjencat të komunës së Prishtinës,
- Takim me Federatën e Futbollit të Kosovës FFK,
- Task Njësia Britanike e KFOR-it vizituan KRU"Prishtina"
- Takim me ARRU-në / Verifikimi i të dhënave , TM1 dhe Raporti Vjetor
- Takim me ME dhe përgaditjen e Kërkesë për mbështetje financiare me qëllim të investimeve të projekteve për furnizim me ujë për vendbanimet:

Komuna e Shtimes: Rehabilitimi i rrjetit të kanalizimit në fshatra,

Komuna e Graçanicës: Projekti i ujësjellësit për fshatrat Kishnicë dhe Batushë dhe

Komuna e Podujevës: Projekti i ujësjellësit për fshatrat Bellopojë, Llugë dhe Orrllan,

Përveç aktiviteteve/takimeve zyrtare, fokusi i ndërmarrjes ka qenë i bazuar edhe në aktivitete të përditshme si:

- Promovimi i aplikacionit e-krup në IOS dhe Android.
- Dalja me 7 televizione nacionale, përcjellje e aksionit të shkyçjeve të dy objekteve banesore, konsumatorë ilegal.

Maj 2023

- Takimi me delegacionin nga zyra qendrore e KfW-së ,
- Nënshkrimi i marrëveshjes për financimin e projekteve kapitale mes palëve Ministria e Ekonomisë e Republikës së Kosovës – Njësia për Politikat dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike dhe Kompania Rajonale e Ujësjellësit Prishtina. Ministria financon Ndërmarrjen me mjetet në shumë totale prej 440,000.00 euro për projektet:
 - Rehabilitimi i kanalizimit në 10 fshatrat të Komunës së Shtimes prej 190,000.00 euro.
 - Rehabilitimi dhe ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Kishnicë të Komunës së Graçanicës në vlerë:100,000.00euro.

- Rehabilitimi dhe ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatrat Bellopojë, Llugë, Orlan dhe rrethin të Komunës së Podujevës në vlerë prej: 150,000.00 euro
- Punimi i planit të veprimit për zvoglimin/reduktimin e humbjeve të ujit për vitin 2023.
- Takim me ARRU-në / Verifikimi i të dhënave,
- Takimi me kryetarin e komunës së Shtimes për bashkëpunimin e realizimit të projeteve të përbashkëta.
- Takimi me kryetarin e komunës së Podujevës për bashkëpunimin e relalizimit të projeteve të përbashkëta.
- Plotësimi i listës prioritare të projekteve infrastrukturore sipas kërkesës së zyres së Kryeministrit dhe Ministrisë së MMPH-së.
- Barometri i qasshmërisë së faqeve të internetit të institucioneve publike për personat me aftësi të kufizuar e organizuar nga SHPIK për "Ditën Ndërkombëtare të Qasshmërisë". KRU"Prishtina" në vendin e dytë nga gjithsej 7 institucione publike derisa 66 nuk i plotësuan standardet ndërkombëtare, si: Web Accessibility Directive (2016/2102/EU), European Accessibility Act (EAA) dhe United Nations Convention on the Rights of Persons with Disabilities (UNCRPD).
- Pjesëmarrja në ceremonin e 15 vjetorit të Marrëdhënieve Diplomatike Gjermani-Kosovë,
- Takimi i rregullt me Ekipin ndërlidhës për monitorim nga KFOR-i italian në KRU"Prishtina",
- Aplikimi i shkyçjeve nga sistemi publik i ujësjellësit për objektet banesore të cilat nuk i kanë plotësuar kushtet teknike,

Qershor 2023

- Takimi me delegacionin nga zyra qendrore e KfW-së ,
- Nënshkrimi i marrëveshjes lidhja e Memorandum Miërkuptimit me komunën e Shtimes për financimin e përbashkët të projektit "Rehabilitimi/ndërtimi i ujësjellësit dhe kanalizimit" në vlerë totale prej 250,000€
- Nënshkrimi i marrëveshjes lidhja e Memorandum Miërkuptimi me komunën e Graçanicës për financimin e përbashkët të projektit " Rehabilitimi dhe ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Kishinicë dhe Batushë" në vlerë totale prej 125,000€
- Nënshkrimi i marrëveshjes lidhja e Memorandum Miërkuptimi me komunën e Podujevës për financimin e përbashkët të projektit " Rehabilitimi dhe vazhdimi i ndërtimit të Ujësjellësit për fshatrat Bellopoje, Llugë, Orlan dhe rrethinë të Komunës së Podujevës" në vlerë totale prej 235,000€
- Takimi me zyrtarët e AFD-së në zyret e KRU Prishtinës,
- Punimi i planit të veprimit për zvoglimin/reduktimin e humbjeve të ujit për vitin 2023.
- Takim me ARRU-në / Verifikimi i të dhënave,
- Plotësimi i listës prioritare të projekteve infrastrukturore sipas kërkesës së zyres së Kryeministrit dhe Ministrisë së MMPH-së.
- Aplikimi i shkyçjeve nga sistemi publik i ujësjellësit për objektet banesore të cilat nuk i kanë plotësuar kushtet teknike,
- KRU " Prishtina " po monitoron cilësinë e ujit të pijshëm 24 h pa ndërprerë,
- Njoftime për nivelin e ujit në liqenet akumuluese sipërfaqësore Batllava e Badoci,
- Njoftime të rëndësishme për punime teknike në rrjetin e ujësjellësit,
- Njoftime për kërkesë të konsumatorëve për pagesa të shërbimeve për ujë e kanalizim,
- Njoftime të rëndësishme, ku palë të treta dëmtuan gypat e ujit,
- Njoftime për shpenzim racional të ujit të pijshëm dhe mbrojtja e burimeve të ujit .


II. DEPARTAMENTI TEKNIK

2.1 Prodhimi

Tabala nr.1 – Prodhimi – Prill- Qershor-2023

Nr.	Njësia Operative	Prill	Maj	Qershor	TM2-2023
1	PRISHTINE	3,086,098	3,101,675	2,896,532	9,084,305
2	GRACANICË	139,315	142,302	135,966	417,583
3	FUSHE KOSOVE	493,185	517,251	530,057	1,540,493
4	PODUJEVE	346,380	346,030	346,770	1,039,180
5	OBILIQ	251,300	244,394	231,363	727,057
6	LIPJAN	207,260	261,862	209,677	678,799
7	SHTIME	67,195	68,010	74,740	209,945
8	DRENAS	130,300	236,262	165,461	532,023
9	Gjithsej- KRUP	4,721,033	4,917,786	4,590,566	14,229,385

Diagrami nr.1 – Prodhimi TM2-2023




Koment : Siç shihet ne grafikun, por edhe ne tabelë, sasia volumetrike e trajtuar është me e vogël ne krahasim me vitin e kaluar ne pjesën dërmuese te NJOU-ve dhe ky është faktori kyc që ka ndikuar te ulen humbjet apo UPF.

Tabala nr2 - Prodhimi –TM2-2022/2023

Nr.	Njësia Operative	TM2-2022	TM2-2023	Dallimi	Dallimi në %
1	PRISHTINE	8,914,669	9,084,305	169,636	1.9%
2	GRACANICË	454,201	417,583	-36,618	-8.1%
3	FUSHE KOSOVE	1,734,338	1,540,493	-193,845	-11.2%
4	PODUJEVE	1,085,200	1,039,180	-46,020	-4.2%
5	OBILIQ	861,852	727,057	-134,795	-15.6%
6	LIPJAN	627,660	678,799	51,139	8.1%
7	SHTIME	194,080	209,945	15,865	8.2%
8	DRENAS	405,450	532,023	126,573	31.2%
9	Gjithsej- KRUP	14,277,450	14,229,385	-48,065	-0.3%


PRODHIMI



Koment: Arsye e trajtimit ne sasi me pak për Qershor janë si shkak i mos punës me kapacitet te plote ne Shkabaj, si shkak i turbullirës, po ashtu aplikimi i reduktimeve ne zona te ndryshme si Prishtine, Podujeve, Lipjan

Tabala nr.4 Realizimi i cageve- Prodhimi TM2-2023

Nr.	Njësia Operative	TM2-2023	Planifikimi	Dallimi	Dallimi në %	Realizimi-në %
1	PRISHTINE	9,084,305	8,255,312	828,993.00	9.13%	109.13%
2	GRACANICË	417,583	449,600	(32,017.00)	-7.67%	92.33%
3	FUSHE KOSOVE	1,540,493	1,763,168	(222,675.00)	-14.45%	85.55%
4	PODUJEVE	1,039,180	1,152,166	(112,986.00)	-10.87%	89.13%
5	OBILIQ	727,057	855,852	(128,795.00)	-17.71%	82.29%
6	LIPJAN	678,799	589,680	89,119.00	13.13%	113.13%
7	SHTIME	209,945	196,560	13,385.00	6.38%	106.38%
8	DRENAS	532,023	314,496	217,527.00	40.89%	140.89%
9	Gjithsej- KRUP	14,229,385	13,576,834	23,585.00	0.17%	100.17%



Komente: Janë bere korrigjimet konform matjeve dhe ndarjes për njësi operative, ne zonat ku furnizohen nga e njëjta pike furnizimi, si dhe muaji Maj sipas raportit të NJAB

2.2 Situata e furnizimit

Furnizimi me ujë në zonën e shërbimit gjatë tre mujorit të dytë ka qenë me vështirësi të herë pas herë, me theks të veçantë fundi i muajve, pasi që siç dihet kishte reshje me intensitet të lartë, rrjedhimisht turbullirë në burime të ujit, sidomos në burime sipërfaqësore. Për fat të keq vështirësitë më të mëdha ishin në dy marrjet nga kanali i hapur i sistemit të NH Ibër Lepenc, ku për pasojë qyteti i Drenasit për një kohë rreth 1 javë ishte në masa emergjente të furnizimit me ujë, kur për pasojë furnizimi ka qenë i varur në shumicën e kohës përmes auto boteve. Situata diçka më të lehtë kishte Fushë Kosova, por prap me reduktime, duke qenë se ITUP Shkabaj nuk kishte mundësi trajtimi të ujit për pije, një lloj edhe qyteti i Obiliqit. Me qëllim që të tejkalohet një situatë e tillë me kushte ekstreme të vështira për furnizim me ujë, drejtoria teknike me të gjitha kapacitetet gjatë TM 2 - 2023, ishte e obliguar të aplikoj reduktime të furnizimit me ujë në shumicën e njësive operative, përjashtimisht në Shtime dhe Lipjan. Pastaj në muajt Shkurt dhe Mars, prap janë shfaqur probleme me furnizim si pasojë e turbullirës së lartë në kanal, por se ishin në periudha me të shkurtra kohore, duke mos shqetësuar konsumatorët, sepse reduktime fokusoheshin vetëm gjatë natës. Niveli i dy akumulimeve në Batllave dhe Badovc është i mirë, Batllava ka kohë që ka kaluar nivelin e kapërderdhës, ndërsa Badovci është në kapërderdhje në këtë tre muaj. Shqetësuese mbetet niveli i turbullirës në kanal dhe pamundësia e trajtimi të ujit në ITUP Shkabaj në rastet kur ka reshje. Furnizimi ka vazhduar pa probleme tjera për periudhën në vazhdim, mirëpo problemet janë shfaqur me ngritjen e temperaturave, si pasojë e keqpërdorimit të enrom të ujit, pastaj infrastrukturës së kufizuar për të përballuar një kërkesë të tillë për ujë.

2.3 Detektimi

Tabala nr.5 Ekipa e detektimit – TM2-2023

Nr.	Njësia Operative	Detektimet sipas kërkesave	Detektimet e planifikuara	Gjatësia e rrjetit të detektuara	Nr. i defekteve të identifikuar	Nr. i lidhjeve të paligjshme
1	PRISHTINE	66	40,000	31,000	119	-
2	GRACANICË	1	0	0	0	-
3	FUSHE KOSOVE	13	0	0	0	-
4	PODUJEVE	11	0	200	0	-
5	OBILIQ	4	0	100	0	-
6	LIPJAN	12	0	200	2	-
7	SHTIME	3	0	0	0	-
8	DRENAS	5	0	0	4	-
9	Gjithsej- KRUP	115	40,000	31,500	125	-

Koment: Arsye se përse nuk ka aktivitet në njësitë tjera operative, është se nuk ka staf të dedikuar të cilët merren me detektim. Njësitë Operative Lipajn, Drenas dhe Podujevë, kane pajisje minimale, por staf nuk kanë, ndërsa njësitë tjera operative nuk kane fare as pajisje, por as staf. Të gjitha njësitë i mbulon qendra dhe raportimet bëhen nga qendra ne shumicën e rasteve.

Tabala Nr.6 Ekipa e detektimit – TM2-2023

Nr.	Njësia Operative	Detektimet sipas kërkesave	Detektimet e planifikuara	Gjatësia e rrjetit të detektuara (m)	Nr. i defekteve të identifikuar	Nr. i lidhjeve të paligjshme
1	Prill	33	15,000	11,000	25	0
2	Maj	34	15,000	13,000	52	0
3	Qershor	48	10,000	7,500	48	0
4	Gjithsej- KRUP	115	40,000	31500	125	0

Tabala nr.7 Ekipa e detektimit –TM2-2022/2023

Nr.	Njësia Operative	Detektimet sipas kërkesave	Detektimet e planifikuara	Gjatësia e rrjetit të detektuara	Nr. i defekteve të identifikuar	Nr. i lidhjeve të paligjshme
1	TM2-2022	336	40,000	26,500	64	-
2	TM2-2023	115	40,000	31,500	125	-

Koment: Në rast se do të plotësoheshin pozitat vakante, por do furnizohen edhe me pajisje dhe ngritje kapacitetesh, duke alokuar stafin adekuat, atëherë mundësitë dhe nevojat janë për shumë më shumë detektive. Ekipi aktual është vetëm me 3 punonjës

2.4 Intervenimet ne rrjet

Tabala nr.8 Intervenimet ne rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit – TM2-2023


Nr.	Njësia Operative	Intervenimet në rrjetin e ujësjellësit	Intervenimet në rrjetin e kanalizimit	Intervenimet të tjera	Gjithsej - Intervenime
1	PRISHTINE	306	592	40	938
2	GRACANICË	52	117	0	169
3	FUSHE KOSOVE	88	60	1	149
4	PODUJEVE	85	60	35	180
5	OBILIQ	23	41	0	64
6	LIPJAN	87	157	9	253
7	SHTIME	195	106	0	301
8	DRENAS	87	78	0	165
9	Gjithsej- KRUP	923	1,211	85	2,219

Koment: Intervenimet në Kanalizime, janë raportuar ato që bëhen nga qendra, ndërsa ne rrjetin e ujësjellësit janë raportuar, ato çfarë kanë raportuar menaxherët e Njësive Operative. Fushë Kosova nuk ka ekip të mirëmbajtjes, mbulohet nga qendra.

Tabala nr.9 Intervenimet ne rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit – TM2-2022/2023

Nr.	Perkshkrimi	Intervenimet në rrjetin e ujësjellësit	Intervenimet në rrjetin e kanalizimit	Intervenimet të tjera	Gjithsej - Intervenime
1	TM2-2022	465	1136	32	1,633
2	TM2-2023	923	1,211	85	2,219


INTERVENIMET NË RRJET



Tabala nr.10 Intervenimet ne rrjetin e ujës-jellës dhe kanalizimit – TM2-2023

Nr.	Përshkrimi	Intervenimet në rrjetin e ujës-jellës	Intervenimet në rrjetin e kanalizimit	Intervenimet të tjera	Gjithsej - Intervenime
1	Prill	253	306	37	596
2	Maj	338	371	24	733
3	Qershor	332	534	24	890
4	Gjithsej	923	1,211	85	2219

Diagrami nr.3 Intervenimet ne rrjetin e ujës-jellës dhe kanalizimit – TM2-2023



Tabala nr.11 Pastrimi i pushtave te kanalizimit – TM2-2023

Nr.	Njësia Operative	Pastrimi i pushtave	Pastrimi i pushtave me shpërlarje	Vendosja e kapakëve te pushtave	Rehabilitimi i rrjetit
1	PRISHTINE	79	2,368	3	115
2	GRACANICË	1	468	0	15
3	FUSHE KOSOVE	0	232	0	2
4	PODUJEVE	0	156	0	44
5	OBILIQ	1	17	0	85
6	LIPJAN	18	36	0	8
7	SHTIME	30	40	0	0
8	DRENAS	6	96	0	12
9	Gjithsej- KRUP	135	3,413	3	281

Koment: Në rast se plotësohen mungesat nëpër Njësi Operative, atëherë rastet e ndërhyrjeve me pastrim pushtash do të shtoheshin dhe mirëmbajtja do ishte me e mirë

Tabala nr.12 Pastrimi i pusetave te kanalizimit – TM2-2023

Nr.	Përshkrimi	Pastrimi i pusetave	Pastrimi i pusetave me shpërlarje	Vendosja e kapakëve te pusetave	Rehabilitimi i rrjetit
1	Prill	63	846	1	190
2	Maj	29	1044	1	4
3	Qershor	43	1523	1	87
4	Gjithsej	135	3,413	3	281

Tabala nr.13 Pastrimi i pusetave te kanalizimit – TM2-2022/2023

Nr.	Përshkrimi	Pastrimi i pusetave	Pastrimi i pusetave me shpërlarje	Vendosja e kapakëve te pusetave	Rehabilitimi i rrjetit
1	TM2-2022	85	3,408	9	3
2	TM2-2023	135	3,413	3	281

2.5 Shërbimi i ndërrimit të ujëmatësve

Tabala nr.14 Ndërrimi i ujëmatësve – TM2-2023

Nr.	Njësia Operative	Shtëpiak	Komerical	Institucional	Gjithsej
1	PRISHTINE	195	20	7	222
2	GRACANICË	1	-	-	1
3	FUSHE KOSOVE	-	-	-	-
4	PODUJEVE	2	-	-	2
5	OBILIQ	-	1	-	1
6	LIPJAN	-	-	-	-
7	SHTIME	-	-	-	-
8	DRENAS	-	-	-	-
9	Gjithsej- KRUP	198	21	7	226

Koment: Nuk ka mundësi të bëhen me shume ndërrime, sepse ka vetëm qendra ekip për ndërrim te matësve, dhe atë janë vetëm 4 punonjës.

Tabala nr.15 Ndërrimi i ujëmatësve – TM2-2022/2023

Nr.	Përshkrimi	Shtëpiak	Komerical	Institucional	Gjithsej
1	TM1-2022	188	20	1	209
2	TM2-2023	198	21	7	226

2.6 Aplikime për kushte teknike

Tabala nr.16 Periudha raportuese:(TM2) 2023

Nr.	Njësia Operative	Aplikime	Të kryera	Në procedurë
1	PRISHTINE	52	29	23
2	GRACANICË	10	7	3
3	FUSHE KOSOVE	1	0	1
4	PODUJEVE	4	8	
5	OBILIQ	6	6	
6	LIPJAN	10	6	4
7	SHTIME	5	7	
8	DRENAS	5	5	4
9	Gjithsej- KRUP	93	68	35

2.7 Aplikime për kyçje të reja

Tabala nr.17 Periudha raportuese:(TM2) 2023

Nr.	Njësia Operative	Aplikime	Të kryera	Në procedurë
1	PRISHTINE	52	59	14
2	GRACANICË	17	19	1
3	FUSHE KOSOVE	1	4	1
4	PODUJEVE	14	16	2
5	OBILIQ	4	9	0
6	LIPJAN	23	25	6
7	SHTIME	14	17	1
8	DRENAS	8	15	0
9	Gjithsej- KRUP	133	164	25

2.8 Projektet për zbatim/Investimet Kapitale/Plani i Prokurimit/DPZH

Tabala nr.18 Periudha raportuese:(TM2) 2023

Hartimi i Projekteve për Zbatim të planifikuara në periudhën raportuese të TM1 nga DPZH-se

Nr.	Investimet Kapitale/DPZH/Emërtimi i Projektit	Statuti /Projekti	Projekti në proces
1	Ndërtimi dhe riparimi i pushtave të ujësjellësit dhe kanalizimit	I përfunduar	Ne proces të prokurimit
2	Ndërrimi dhe ndërtimi i rrjetit të ujit për përmirësimin e furnizimit dhe zvogëlimin e humbjeve në zonën e shërbimit të KUR Prishtina (Prishtinë, Lipjan, Podujevë, Obiliq, Shtime, Fushë Kosovë, Gracanice dhe Drenas)_Lot	I përfunduar	Ne proces të Prokurimit
3	Rehabilitimi ndërtimor - arkitektonik i objekteve të trajtimit dhe shpërndarjes	I përfunduar	

4	Projekte të ndryshëm të bashkëfinancimit me komunat, komunitetin, donatorët. Fokusimi në zgjerimin e rrjetit, zëvendësimi i rrjetave të amortizuara dhe mirëmbajtje dhe operim të të njëjtave (rrjeti i ujit dhe ujërave të ndotura)_Lot 2 - Projekti i rehabilitimit të ujësjellësit të fshatit Kishnice - Projekti i rehabilitimit të ujësjellësit të fshatave, Bellopoja, Lluga 3. Projekti i ri i furnizimit me ujë për fshatin Batusha-Gracanice 4. Rehabilitimi i Kolektorit të Ujërave të Zeza-Shtime	Te përfunduara	Janë lidhur Memorandume të bashkëfinancimit me Komuna
5	Zgjerimi i kapaciteteve prodhuese të ujit- hapja e puseve nëntokësore në zonën e KRUP _Lot 1	Te përfunduar	Ne proces të prokurimit

2.9 Problemet e evidentuara

Vjetërsia e rrjetit të shpërndarjes dhe rrjetit të ujërave të ndotura, bënë që të ketë ndërhyrje të shpeshta në sistemet e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura.

Mungesa e stafit dhe mosha e shtyrë e tyre ndikon në punët ditore, me qëllim që të kryhen më shpejt rastet dhe në anën tjetër të ketë me pak humbje teknike të ujit. Mungesa e transparencës, emërimeve në pozita të personave që rrezikojnë mbarëvajtjen dhe asetet edhe problem serioz në ndërmarrje. Përveç mungesës së stafit ka mungesa edhe në logjistikë, sepse auto mekanizmi është i tejet i amortizuar.

2.10 Masat e propozuara

Rekrutimi i stafit sipas kërkesave, për plotësim të vendeve vakante duke përfshirë Planin e biznesit, duke u bazuar në profesionalizëm dhe transparencë të plote ligjore.

Ndërrimi i infrastrukturës së vjetër me të re, blerja dhe ripërtëria pajisjeve logjistike, mjeteve të punës.

Me rritjen e kapaciteteve njerëzore do të arrijmë formimin e ekipeve monitoruese profesionale, gjë që do të ndikonte dukshëm në arritjen dhe realizimin e planifikimeve, mirëmbajtjes preventive, kontrollin dhe monitorimin, kushte me të cilat do të arrihej përmirësimi i objektivave dhe rritja e performancës.

2.11 Aktivitetet për zvogëlimin e UPF-së

Mungesa e emërimit të koordinatorit për UPF ka bërë që pjesa e drejtorisë teknike – DPZH të merret me analizat e DMA-ve të cilat ekzistojnë që nga 2017-ta. Veprime tjera nuk ka pasur, ne mungesa të stafit neper departamente dhe njësi.

III. DEPARTAMENTI KOMERCIAL

3.1 Numri i konsumatorëve

Tabala nr.19 Numri i konsumatorëve -- TM2-2023

Nr.	Njësia Operative	Prill	Maj	Qershor	TM2-2023
1	Prishtinë	94,888	95,601	96,436	96,436
2	Fushë Kosovë	26,328	27,494	27,623	27,623
3	Obiliq	6,172	6,161	6,167	6,167
4	Graçanicë	3,825	3,827	3,827	3,827
5	Shtime	3,785	3,787	3,800	3,800
6	Lipjan	12,221	12,256	12,422	12,422
7	Podujevë	12,394	12,398	12,424	12,424
8	Drenas	6,320	6,330	6,356	6,356
9	Gjithsej- KRUP	165,933	167,854	169,055	169,055

Tabala nr.20 Nr. i konsumatorëve -- TM2-2022/2023

Nr.	Njësia Operative	TM2-2022	TM2-2023	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI- %
1	Prishtinë	90,461	96,436	5,975	6.6%
2	Fushë Kosovë	24,178	27,623	3,445	14.2%
3	Obiliq	6,083	6,167	84	1.4%
4	Graçanicë	3,762	3,827	65	1.7%
5	Shtime	3,686	3,800	114	3.1%
6	Lipjan	11,890	12,422	532	4.5%
7	Podujevë	12,130	12,424	294	2.4%
8	Drenas	6,182	6,356	174	2.8%
9	Gjithsej- KRUP	158,372	169,055	10,683	6.7%

NUMRI I KONSUMATORËVE





Tabela nr.21 Realizimi i çaqeve- Numri i konsumatorëve – TM2-2023

Nr.	Njësia Operative	TM2-2023	Planifikimi	Dallimi	Dallimi në %	Realizimi në %
1	Prishtinë	96,436	94,359	2,077	2.20%	102.20%
2	Fushë Kosovë	27,623	25,298	2,325	9.19%	109.19%
3	Obiliq	6,167	6,340	-173	-2.73%	97.27%
4	Graçanicë	3,827	3,963	-136	-3.43%	96.57%
5	Shtime	3,800	3,852	-52	-1.35%	98.65%
6	Lipjan	12,422	12,414	8	0.06%	100.06%
7	Podujevë	12,424	12,705	-281	-2.21%	97.79%
8	Drenas	6,356	6,454	-98	-1.52%	98.48%
9	Gjithsej- KRUP	169,055	165,385	3,670	2.22%	102.22%

NR. I KONSUMATORËVE



Komenti: Prishtina , Fushë Kosova dhe Lipjani janë njësit të cilat kanë realizuar caqet sipas planit të biznesit me numrin e konsumatorëve në periudhën TM2.Përforma në numrin e konsumatorëve është tejkaluar mbi 100% në krahasim me planifikim .

3.2 Faturimi -m3

Tabela nr.22 Faturimi m3 – TM2-2023

Nr.	Njësia Operative	Prill	Maj	Qershor	TM2-2023
1	Prishtinë	1,261,174	1,341,777	1,341,799	3,944,750
2	Fushë Kosovë	220,676	229,031	206,565	656,272
3	Obiliq	103,315	106,945	110,766	321,026
4	Graçanicë	66,132	79,891	93,203	239,226
5	Shtime	35,655	32,648	43,027	111,330
6	Lipjan	95,648	104,198	95,345	295,191
7	Podujevë	138,848	149,122	145,248	433,218
8	Drenas	53,952	54,602	54,478	163,032
9	Gjithsej- KRUP	1,975,400	2,098,214	2,090,431	6,164,045

Tabela Nr.23 Faturimi m3 – TM2-2022/2023

Nr.	Njësia Operative	TM2-2022	TM2-2023	Dallimi	Dallimi në %
1	Prishtinë	3,886,133	3,944,750	58,617	1.49%
2	Fushë Kosovë	679,254	656,272	-22,982	-3.50%
3	Obiliq	346,276	321,026	-25,250	-7.87%
4	Graçanicë	137,631	239,226	101,595	42.47%
5	Shtime	118,462	111,330	-7,132	-6.41%
6	Lipjan	304,920	295,191	-9,729	-3.30%
7	Podujevë	454,164	433,218	-20,946	-4.83%
8	Drenas	187,402	163,032	-24,370	-14.95%
9	Gjithësej- KRUP	6,114,242	6,164,045	49,803	0.81%

FATURIMI- m3





Tabela Nr.24 Realizimi i caqeve -Faturimi m3 – TM2-2023

Nr.	Njësia Operative	TM2-2023	Planifikimi	Dallimi	Dallimi në %	Realizimi-në %
1	Prishtinë	3,944,750	4,106,539	-161,789	-3.94%	96.06
2	Fushë Kosovë	656,272	691,656	-35,384	-5.12%	94.88
3	Obiliq	321,026	384,632	-63,606	-16.54%	83.46
4	Graçanicë	239,226	155,552	83,674	53.79%	153.79
5	Shtime	111,330	141,976	-30,646	-21.59%	78.41
6	Lipjan	295,191	335,051	-39,860	-11.90%	88.10
7	Podujevë	433,218	462,509	-29,291	-6.33%	93.67
8	Drenas	163,032	180,070	-17,038	-9.46%	90.54
9	Gjithësej- KRUP	6,164,045	6,457,984	-293,939	-4.55%	95.45



Koment: Gjate periudhës TM2, duke u bazuar ne planifikim të faturimit në sasi m3, ka rritje në qytetin në Graçanicës për 53.79 % . Ky tejkalim rezulton me leximin e ujematësve, pasi që një kohë të gjatë kjo zonë ka qenë e pa mbuluar me lexues.Me pranimin e lexuesëve nga muaji Janar 2023 ka ngritje të performances me lexim të faturimit në sasi m3 në njësin e Graçanicës Në total në të gjitha njësit realizimi i faturimit në sasi m3 në krahasim me planifikimin është 95.45% .

3.3 Faturimi -€

Tabela nr.25 Faturimi € – TM2-2023

Nr.	Njësia Operative	Prill	Maj	Qershor	TM2-2023
1	Prishtinë	830,140	870,451	876,175	2,576,767
2	Fushë Kosovë	149,178	162,242	140,585	452,006
3	Obiliq	66,657	68,748	71,381	206,785
4	Graçanicë	41,595	47,289	53,304	142,187
5	Shtime	22,743	21,016	26,788	70,546
6	Lipjan	62,570	66,599	64,151	193,320
7	Podujevë	85,649	90,342	88,719	264,710
8	Drenas	35,157	35,589	36,586	107,332
9	Gjithsej- KRUP	1,293,689	1,362,275	1,357,688	4,013,653

Tabela nr.26 Faturimi € – TM2-2022/2023

Nr.	Njësia Operative	TM2-2022	TM2-2023	Dallimi	Dallimi në %
1	Prishtinë	2,469,854	2,519,613	49,759	1.97%
2	Fushë Kosovë	450,328.83	448,983	-1,346	-0.30%
3	Obiliq	217,456.60	205,418	-12,039	-5.86%
4	Graçanicë	85,527.32	139,963	54,436	38.89%
5	Shtime	58,179.32	68,643	10,464	15.24%
6	Lipjan	180,116.37	191,318	11,202	5.85%
7	Podujevë	269,350.02	263,363	-5,987	-2.27%
8	Drenas	117,553.53	106,508	-11,046	-10.37%
9	Gjithsej- KRUP	3,848,366	3,943,809	95,443	2.42%

TM2 2022 - TM2 2023




Tabela nr.27 Realizimi i caqeve -Faturimi € - TM2-2023

Nr.	Njësia Operative	TM2-2023	Planifikimi	Dallimi	Dallimi në %	Realizimi-në %
1	Prishtinë	2,576,767	2,585,819	-9,052	-0.35%	99.65%
2	Fushë Kosovë	452,006	453,699	-1,693	-0.37%	99.63%
3	Obiliq	206,785	243,249	-36,464	-14.99%	85.01%
4	Graçanicë	142,187	100,834	41,353	41.01%	141.01%
5	Shtime	70,546	90,896	-20,350	-22.39%	77.61%
6	Lipjan	193,320	231,792	-38,472	-16.60%	83.40%
7	Podujevë	264,710	293,209	-28,499	-9.72%	90.28%
8	Drenas	107,332	118,718	-11,387	-9.59%	90.41%
9	Gjithsej- KRUP	4,013,653	4,118,215	-104,563	-2.54%	97.46%

Realizimi i caqeve -Faturimi €




Koment: Në total realizimi i faturimit në € është 97.46 %. Edhe të faturimi në euro prin me performanc të mirë Graçanica.

Arsyeja e ngritjes së faturimit në njësin e Graçanicës, është se nga muaji janar janë pranuar dy lexues dhe kanë mbuluar terenin në këtë njësi ndërsa në njësit tjera ende ka munges të lexueseve në mbulushmërin e terrenit.

Tabela nr.28 Realizimi i cageve pas zbritjes së largimeve dhe përmirësimeve -Faturimi € – TM2-2023

Nr.	Njësia Operative	TM2-2023	Planifikimi	Dallimi	Dallimi në %	Realizimi-në %
1	Prishtinë	2,519,613	2,585,819	-66,206	-2.56%	97.44%
2	Fushë Kosovë	448,983	453,699	-4,716	-1.04%	98.96%
3	Obiliq	205,418	243,249	-37,831	-15.55%	84.45%
4	Graçanicë	139,963	100,834	39,129	38.81%	138.81%
5	Shtime	68,643	90,896	-22,253	-24.48%	75.52%
6	Lipjan	191,318	231,792	-40,474	-17.46%	82.54%
7	Podujevë	263,363	293,209	-29,846	-10.18%	89.82%
8	Drenas	106,508	118,718	-12,210	-10.29%	89.71%
9	Gjithsej- KRUP	3,943,809	4,118,215	-174,406	-4.23%	95.77%



Koment: Në tabelën e mësipërme janë pasqyruar të dhënat e faturimit pas përmirësimeve nga gabimet në lexim apo mos leximi sipas rregullores, janë të larguara përmes vendimeve nga komisioni i shqyrtimit të ankesave/kërkesave apo vendimeve nga komisioni i ARRU-së.

3.4 Arkëtimi - €

Tabela Nr.29 Arkëtimi € – TM2-2023


Nr.	Njësia Operative	Prill	Maj	Qershor	TM2-2023
1	Prishtinë	713,932	828,181	783,841	2,325,955
2	Fushë Kosovë	136,935	140,525	143,660	421,119

3	Obiliq	78,257	72,185	65,072	215,513
4	Graçanicë	26,686	35,364	26,398	88,448
5	Shtime	19,599	20,136	21,058	60,794
6	Lipjan	61,816	62,407	58,445	182,669
7	Podujevë	66,834	73,075	75,418	215,328
8	Drenas	80,929	34,404	35,318	150,651
9	Gjithsej- KRUP	1,184,989	1,266,277	1,209,209	3,660,475

Tabela Nr.30 Arkëtimi € – TM2-2022/2023

Nr.	Njësia Operative	TM2-2022	TM2-2023	Dallimi	Dallimi në %
1	Prishtinë	1,899,904	2,325,954	426,050	22.4%
2	Fushë Kosovë	345,506	421,120	75,614	21.9%
3	Obiliq	186,731	215,514	28,783	15.4%
4	Graçanicë	58,673	88,448	29,775	50.7%
5	Shtime	50,676	60,793	10,117	20.0%
6	Lipjan	146,225	182,668	36,443	24.9%
7	Podujevë	216,395	215,327	-1,068	-0.5%
8	Drenas	91,118	150,651	59,533	65.3%
9	Gjithsej- KRUP	2,995,228	3,660,475	665,247	22.2%

ARKËTIMI- €




Koment: Ne tabelën e krahasimit të TM2 2022 dhe TM2 2023, vërehet dukshëm që kemi arkëtim më të lartë në periudhat krahasuese, kemi rritje të arkëtimit për 18.17 % në krahasim me vitin e kaluar.

Tabela nr.31 Realizimi i caqeve –Arkëtimi – TM2-2023

Nr.	Njësia Operative	TM2-2023	Planifikimi	Dallimi	Dallimi në %	Realizimi-në %
1	Prishtinë	2,325,955	2,533,704	207,749	8.20%	91.80%
2	Fushë Kosovë	421,119	443,846	22,727	5.12%	94.88%
3	Obiliq	215,513	238,826	23,313	9.76%	90.24%
4	Graçanicë	88,448	66,904	-21,544	-32.20%	132.20%

5	Shtime	60,794	89,062	28,268	31.74%	68.26%
6	Lipjan	182,669	227,394	44,725	19.67%	80.33%
7	Podujevë	215,328	287,080	71,752	24.99%	75.01%
8	Drenas	150,651	116,170	-34,481	-29.68%	129.68%
9	Gjithsej- KRUP	3,660,475	4,002,986	342,511	8.56%	91.44%



Koment: Gjate periudhës Prill-Qershor, në njësit e Graçanicës ka pasur progres për arsye të leximit të rregullt nga lexuesit e ri, ndërsa në njësin e Drenasit kemi pranuar pagesë nga intitucioni MTI për borxhin e mëhershëm. Gjate kësaj periudhe, kemi rënje në shkallën e arkëtimit në krahasim me planifikimin dhe nuk kemi mundur ta realizojmë edhe për arsye të pagesave më të ulta në muajin Ramazan.

3.5 Ankesat/Kërkesat teknike dhe komerciale

Tabala nr.32 Ankesat /kërkesat teknike dhe komerciale të shqyrtuara nga komisioni TM2-2023

NR	Njësia Operative	Ankesat teknike	Ankesat T.- Të shqyrtuara me kohë	Ankesat komerciale	Ankesat K.- Të shqyrtuara me kohë	Kërkesë Teknike	Kërkesë teknike të shqyrtuara me kohë	Kërkesë komerciale	Kërkesë komerciale të shqyrtuara me kohë
1	Prishtinë	1	0	351	8	115	23	1643	908
2	F. Kosovë	2	1	12	0	12	1	215	191
3	Obiliq	0	0	13	0	2	0	7	4
4	Graçanicë	0	0	6	0	0	0	70	57
5	Shtime	1	0	9	0	7	1	99	80
6	Lipjan	1	0	22	0	10	1	121	106
7	Podujevë	1	0	40	0	11	1	113	132
8	Drenas	0	0	1	0	7	1	82	75
9	Gjithësej	6	1	454	8	164	28	2350	1,553

Koment: Në tabelat e mësipërme , janë prezantuar të gjitha kërkesat dhe ankesat si komerciale ashtu edhe teknike , të cilat janë pranuar nga konsumatorët në form fizike , me post apo me eamil. Numri i ankesave dhe kërkesave të shqyrtuara brenda muajit,është dukshë më i vogë si rezultat i numrit të madhe të rasteve të pranuar të cilat do të shqyrtohen në muajin në vijim.

3.6 Inspektimi dhe Shkyçja


Tabala nr.33 Inspektimi dhe shkyçja TM2-2023

Nr	Përshkrimi	Prill	Maj	Qershor	TM2
1	Inspektime	79	128	322	529
2	Vizita për borgje	1,803	2,451	2,596	6,850
3	Shkyçjet për borgje	44	79	53	123
4	Rikyçje pas pageses së borgjeve	6	28	31	65
5	Kyçje ilegale	10	73	64	147
6	Raste të dërguara nëgjykatë	0	10	3	13
7	Nr. I pagesave nga konsumatorët	463	532	583	1,578
8	Totali I pagesave pas inspekti.	104,467	123,792	111,564	339,823

Tabala nr.34 Inspektimi dhe shkyçja TM2-2022/2023

Nr.	Përshkrimi	TM2-2022	TM2-2023	Dallimi	Dallimi në %
1	Inspektime	0	529	529	
2	Vizita për borgje	2,929	6,850	3,921	133.9%
3	Shkyçjet për borgje	22	176	154	700.0%
4	Rikyçje të rregullta	7	65	58	828.6%
5	Kyçje ilegale	68	147	79	116.2%
6	Raste të dërguara nëgjykatë	0	13	13	
7	Nr. I pagesave nga konsumatorët	464	1,578	1,114	240.1%
8	Totali I pagesave pas inspektimeve	98,459	339,824	241,365	245.1%

INSPEKTIMET DHE SHKYÇJES



Koment: Në tabelat e mësipërme janë prezantuar të dhënat nga inspektimi dhe shkyçja TM2 si dhe krahasimi i periudhës raportuese TM2 2022(e menaxhuar nga DT dhe TM2 2023 (e

menaxhues ne DK) në krahasim me vitin e kaluar vërehet se të inspektimet dhe shqyrtimet të çdo aktiviteti kemi progres mbi 100%

3.7 Aktivitetet kryesore

Gjatë kësaj periudhe përpos aktiviteteve rutinore, janë realizuar edhe këto aktivitete:

- Të gjitha kërkesat për plotësimin e pozitave me staf në Drejtorin Komerciale sipas planifikimit, janë dërguar dhe janë në proces të rekrutimit të stafit me konkurs të brendshme dhe konkurs të jashtëm;
- Mbajtja e trajnimeve për të gjithë lexuesit, kontrollës dhe inspektorët ka përfunduar gjatë muajit Qershor;
- Draft-Rregullorja për lexim gjithashtu është hartuar;
- Në bashkëpunim me zyrtarët e GIS-it, lexuesit kanë regjistruar të dhënat e konsumatorëve
- Kontrollë sistematike janë duke u kryer edhe nga zyrtarët e lexuesve për verifikimin e saktësisë në ujëmatës;
- Ekipa e inspektimit dhe shqyrtjes në vazhdimësi është duke kryer aktivitetet në zbulimin e kësaj ilegale dhe keqpërdorimit të ujërave;
- Në bashkëpunim me Departamentin e Planifikimit dhe Zhvillimit zyrtarët në departamentin komercial kanë krijuar dhe përfunduar DMA zonat, sipas hartave zonale të pranuar nga DPZH për identifikimin e humbjeve komerciale, si Zona I Bregu i Diellit, Zona II Bregu i Diellit, Zona Ulpian dhe Dardani. Gjithashtu edhe për krijimin e zonës në Tophane janë regjistruar 1295 konsumator mirëpo për arsye të numrit të madhë të konsumatorëve kjo zonë ende nuk ka përfunduar, vazhdon të regjistrohen edhe mbi 2000 konsumator për tu kompletuar. Lexuesit kanë verifikuar zonat e përcaktuara dhe përmes të dhënave nga terreni, për zonat e përfunduara do të bëhet analizë dhe raportohet nga DPZH.

3.8 Problemet e evidentuara

Edhe gjatë periudhës Prill-Qershor TM2 kemi hasur edhe në probleme, pothuajse të njëjta në realizimin e objektivave të përcaktuara në planin e biznesit.

- Ujëmatësit e vjetërsuar dhe nevoja për ndërrimin e tyre si dhe pllumbimi,
- Vazhdon ende faturimi i konsumatorëve me tarif fikse deri sa të bëhet ndërrimi i të gjithë ujëmatësve.
- Probleme në leximin e matësve në disa objekte në të cilat nuk ka qasje (mbylljeve të dyerve të podumeve në objektet e banimit kolektive etj). Pamundësia e leximit të matësve gjatë orarit të punës e të cilat janë të mbyllura (pronarët punojnë po në të njëjtin orar të punës) si dhe probleme të tjera të cilat na përcjellin në vazhdimësi.

3.9 Masat e propozuara

Drejtoria Komerciale ka analizuar performancën e saj gjatë kësaj periudhe, dhe ka identifikuar disa pengesa. Për të adresuar këto probleme dhe për të siguruar një punë më të mirë, janë planifikuar disa aktivitete të cilat na përcjellin në vazhdimësi si vijon:

- Kontrolla të rregullta në terren nga udhëheqësit dhe inspektorë, për të vërtetuar se faturimi nga lexuesit bëhet në bazë të konsumit faktik;
- Përditësimi i bazës së të dhënave në program.
- Vazhdimësi e takime të drejtpërdrejta me konsumatorët që kanë borxhe të papaguara në forma të ndryshme, e në veçanti me institucionet shtetërore, për të arritur marrëveshje për inkasimin e faturave të papaguara dhe nënshkrimin e kontratave të shërbimit;
- Përcaktimi i një komisioni i cili merrët vetëm me shqyrtimin e ankesave/kërkesave si teknike ashtu edhe komerciale .
- Komunikim të vazhdueshëm me mjetet e informimit publik, duke publikuar njoftime në rrjetet sociale si dhe të tjerë;
- Nga muaji Gusht, pasi rregullimit të shtimit të tekstit planifikohet që fatura e konsumatorëve të ju dërgohet me shtim të tekstit si njoftim për pagesë të borgjit në afatin ligjor.
- Filtrimi i konsumatorëve dhe dërgimi i listave të konsumatorë me borxhe të përmbaruesi përmes zyrës ligjore si dhe procedimi i lëndëve në gjykatë për lidhjet ilegale si dhe faturimi i dëmeve të shkaktuara nga lidhjet ilegale
- Zhvillimi i programit Billig-Krijimi i modulit për inspektim, shqyqje duke u harmonizuar të dhënat me departamentet-njesit tjera
- Sipas planit të veprimet të merren veprimet e duhura

IV. DEPARTAMENTI I FINANCAVE

4.1 Aktivitetet kryesore

Në përputhje me obligimet rrjedhëse janë bërë të gjitha veprimet e domosdoshme operative lidhur me trajtimin e çdo dokumenti financiar.

Departamenti është kujdesur për çështjet si në vijim:

- Pagesa e shpenzimeve rrjedhëse
- Kontabilizimi i të gjitha shpenzimeve të operimit dhe investimeve
- Regjistrimi analitik i aseteve


- Komunikimi i vazhdueshëm me auditorët e ZKA-së dhe të NJAB gjatë nënshtrimit të proceseve audituese
- Mirëmbajtja e regjistrimeve, pranimi dhe dorëzimi i stokeve përmes depos.
- Shkarkimi i pagesave të konusmatorëve të paguara nga kanalet online
- Operacionet ditore nëpër arkat
- Pagesa e TVSH- së dhe tatimeve tjera
- Përgatitja e Pasqyrave vjetore financiare

4.2 Shpenzimet – TM2-2023

Tabala nr.35 Realizimi i cageve - Shpenzimet operative – TM2-2022/2023

Nr.	Njësia Operative	TM2-2022	TM2-2023	Dallimi	Dallimi në %
1	Prishtinë	1,813,455	1,914,291	100,836	5.6%
2	Fushë Kosovë	158,518	124,193	-34,325	-21.7%
3	Obiliq	66,244	176,328	110,084	166.2%
4	Graçanicë	39,257	69,936	30,679	78.1%
5	Shtime	76,285	44,768	-31,517	-41.3%
6	Lipjan	170,895	85,044	-85,851	-50.2%
7	Podujevë	124,193	207,478	83,285	67.1%
8	Drenas	157,759	168,831	11,072	7.0%
9	Gjithsej- KRUP	2,606,607	2,790,869	184,262	7.1%

SHPENZIMET



Tabala nr.36 Realizimi i cagueve - Shpenzimet operative – TM2-2023

Nr.	Njësia Operative	TM2-2023	Planifikimi	Dallimi	Dallimi në %	Realizimi-në %
1	PRISHTINË	1,914,290.79 €	1,896,676.09 €	17,614.70 €	0.93%	100.9%
2	PODUJEVË	124,193.06 €	197,722.99 €	-73,529.93 €	-37.19%	62.8%
3	FUSHË KOSOVË	176,328.09 €	307,569.09 €	-131,241.00 €	-42.67%	57.3%
4	OBILIQ	69,935.72 €	164,036.85 €	-94,101.13 €	-57.37%	42.6%
5	GRAQANICË	44,767.75 €	76,159.97 €	-31,392.22 €	-41.22%	58.8%
6	SHTIME	85,044.31 €	58,584.59 €	26,459.72 €	45.16%	145.2%
7	LIPJAN	207,478.32 €	155,249.16 €	52,229.16 €	33.64%	133.6%
8	DRENAS	168,831.05 €	73,230.74 €	95,600.31 €	130.55%	230.5%
9	Gjithsej- KRUP	2,790,869.10 €	2,929,229.48 €	-138,360.38 €	-4.72%	95.3%

Koment: Ndarja e shpenzimeve për njësi është bërë sipas numrit të konsumatorëve, për këtë arsye mund të kemi diferenca gjatë krahasimeve.

4.3 Arsyeshmëria e shpenzimeve

Gjatë periudhës TM2 kemi pasur nivel të shpenzimeve më të ulët sesa shpenzimet e lejuara me Planin e Biznesit 2023-2025, por nëse e krahasojmë me shpenzimet e TM2-2022 kjo vlerë është më e lartë në total gjatë TM2-2023. Në këtë pjesë kryesisht krahasimin do të bëjmë duke me buxhetin sipas Planit të Biznesit.

Më poshtë po i shtjellojmë dallimet kryesore:

- Shpenzimet e blerjes së ujit me shumicë kishin qenë më të ulëta për shkak të nivelit më të ulët të prodhimit të ujit i cili blihet nga Iber Lepenci.
- Një ndryshim tjetër i lehtë kishte qenë tek shërbimet për ARRU, SHUKOS, MMPH etj, këtu vlera kishte qenë nën Planin e Biznesit
- Kategoria e cila kishte dallimet më të theksuara në këtë TM ishte Shpenzimet për materiale dhe reagen kishin qenë dukshëm mbi Planin e Biznesit, për shkakun e ndryshimeve në çmime të kemikaljeve, megjithatë pesha e tyre në totalin e shpenzimeve nuk është e theksuar
- Shpenzimet e Energjisë janë nën vlerën e planifikuar, për arsye se të kushteve të përshtatshme atmosferike dhe në të njëjtën kohe edhe reduktimi i prodhimit kishte ndikuar në uljen e tyre.
- Vlëra e Shpenzimeve të Pagave ishte nën vlerën e planifikuar me PB 2023-2025, niveli i ulët i shpenzimeve kishte ardhur për shkak që ende nuk është arritur të rekrutohet stafi i planifikuar sipas planit të biznesit.
- Shpenzimet e shërbimeve të kontraktuara ishin më të larta për shkak se në TM2 ishin regjistruar shpenzimet e interesit të kredisë.

4.4 Problemet e evidentuara

